

AKT – THEMELIMI
Tirana International Business

Neni 1
Emërtimi dhe statusi ligjor

Në Tiranë, sot më datë 12/06/2025 ne të poshtëshënuarit:

- 1- Ahmed Khairy Mohamed Marzouk i i datëlindjes 31.01.1981 , lindur në Menia, Egjipt dhe banues në Tiranë identifikuar me dokument identifikimi: Numër pasaporte A38874945, me cilësinë e “ortakut themelues” deklaroj se me vullnet të lirë të plotë, mbështetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Regjistrimin e Biznesit“, i ndryshuar, krijojmë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, “**Tirana International Business**” shpk,

Neni 1
Emri, Forma

Shoqëria do të ketë emrin “Tirana International Business” shpk, dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2
Personaliteti juridik


Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Neni 3
Selia

Shoqëria e ka seline në adresë: Rruga “Pasho Hysa”, Kompleksi “Mangalem 21”, nd. 31, k.1, Tiranë.

Neni 4
Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushat e:
Eksport-importit dhe tregtisë së çdo lloj malli, kultivimit, përpunimit, përgatitjes për treg e të shitjes së produkteve bujqësore, blegtorale e të peshkut, investimeve dhe marketingut të pasurisë së paluajtshme, ndërtimit, shitje-blerjeve, dhënies me qera,



Ahmed Marzouk

ndërmjetësimit në fushën e pasurisë së paluajtshme, airbnb, menaxhimit të hoteleve e të restoranteve, transportit, dhënies me qera të makinave, turizmit, guida turistike, agjensi turistike, prenotim dhe bileta të guidave dhe udhëtimeve turistike në Shqipëri dhe jashtë saj, veprimtari të ndryshme në përmbushje të aktivitetit dhe qëllimit të shoqërisë, sistemeve të energjisë së rinovueshme, shkripëzimit të ujit, riciklimit të mbetjeve, shërbimeve të ndryshme ndaj investitorëve të huaj, imbotilimit dhe tregtimit të ujit të pijshëm.

Neni 5 ***Kohëzgjatja***

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj pa afat.

Neni 6 ***Kapitali themeltar***

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërise është 10,000 lekë, i ndarë në 1 kuote, i cili zotërohet si më poshtë:

Ahmed Khairy Mohamed Marzouk, perfaqesuar me numër pasaporte A38874945 zotëron 1 kuotë me vlerë 10,000 (dhjetëmijë) lekë, e cila përbën 100% të kapitalit të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Neni 7 ***Transferimi i kapitalit***


Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj ne Qendren Kombetare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.



Ahmed marzouk

Neni 8 *Organi Vendimmarrës*

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.


Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9 *Administrimi*

Administratori i shoqërisë është:

-Ahmed Khairy Mohamed Marzouk, i datëlindjes 31.01.1981, lindur në Menia, Egjipt dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Numër pasaporte A38874945.

Të dy administratorët e lartpërmendur janë emëruar në këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripëritritje.

 Ahmed Marzouk

Neni 10
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 11
Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 4 kopje, në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.

Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nën për nën nga Ortak themelues të shoqërisë tregtare "Tirana International Business" shpk nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin nga administratori Z. Ahmed Khairy Mohamed Marzouk, sipas të drejtës nga Prokura e Përgjithshme me Nr. repertori: 3303 dhe Nr. koleksioni 1000.

ORTAK THEMELUES

Ahmed Khairy Mohamed Marzouk

Ahmed Khairy Mohamed Marzouk
Përfaqësuar me Prokurë nga

Neveen Abdelkhalek

Neveen Abdelkhalek
Neveen

Ahmed Khairy Marzouk